

## LIBRA E MU AJVE TE KREMTET E SHTATORIT

1. *Nisja e Indiktit, domethene Motit te Ri; Simeoni Stiliti, Ati yne Oshenár; Shen Maria e Miaséneve; Aithalláj, Deshmori i Shenjte; te Dyzét Grate e Shenjta, dhe Ammuni, dhjaku dhe mesónjesi i tyre; Kalista, Evodi dhe Hermogjeni, Deshmoret e Shenjte; Jesúj i Naviut, i Drejti; kujtimi i Zjarrit te Math.*

### PERLESHORJA E INDIKTIT, T. II.

O Krijetár i gjithësisë, qe ke ne dorë kohet e dhe stinat, bekoje kuroren e motit, pas mirësisë sate o Zot, dhe rúaje pópullin dhe shtetin tone, me nermjetimet e Hylíndesës, edhe shpëtona.

### PERLESHORJA E SIMEONIT STILITIT, T. II.

U-bere kollón' e durimit, dhe imitove o Oshenár Steráterit: Vojte si Jobi me durím, u-ngave si Jesefi ne Misír, dhe rrojte tërë jeten si një Ëngjell, ne drit' e ne paqesí, Simeón i Shenjte dhe Oshenár, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpëtohen shpirtet tona.

2. *Mamanti, Deshmori i Shenjte; Joani Agjeronjesi, Ati yne i Shenjte, Patriku i Kostandinopojes.*

### PERLESHORJA E JOANIT AGJERONJESIT, T. IV.

#### KANONA PISTEOS

Kanún i besës, edhe kor' e butësisë, mesonjesi i perkores, ndrite përpara besnikëve, me të verteten e púneve; perandáj i fitove me perunjesine të lartat, me varferine të pásurat, Ate Kryepríft

Shen Joán, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpëtohen shpirtet tona.

3. *Anthimi, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Nikomedise; Theoktisti, Ati yne Oshenár, shoku i Shen Efthimit.*

4. *Moisiu, Profeti i Shenjte; Babilla, Hierodeshmori i Shenjte, Peshkopi i Antiokise.*

### PERLESHORJA E MOISIUT, T. II.

Moisi Profét i Shenjte, qe te kremtojme me besë, nermjetó perpara Zotit, te shpëtohen shpirtet tona.

5. *Zaharia, Profeti i Shenjte, i ati i Shen Joán Pazezorit.*

### PERLESHORJA E ZAHARISG, T. IV.

#### KATEPLLAJI JOSIF

I stolisur priftërisht, Profét i Shenjte Zaharí, pas kanunit Hebraík, therore shpinje besërisht, dhe hollokoste mi Alltár te Perendise; keshtú ubere yll, dhe prift i shenjte mistík, dhe çfaqë botërisht, hir te hýjeshme, me fjale dhe me vepërím dhe vdiqe me shpate ne témpullin; Profét i Krishtit, me Shen Joanin, lutju Zotit per neve.

6. *Kujtimi i çudise, qe beri Shen Mehilli, kryegjenerali i Engjejve, ne Kollose te Hónave.*

### PERLESHORJA E SHEN MGHILLIT, T. IV.

#### O IPSOTHIS

O gjenerál i ushterive te qellit, né sherbetoret e pavyer degjona, dhe mprona gjithenjë dhe nermjetó pa pushím, hap-i fletet mi te gjithë né, dhe mbulona me drite, né qe po te lútemi, dhe therre-

sim me besë; O Shen Mchíll shpctona me nxitím, prej çdo reziku, si prijës i Çngjyjeve.

7. *Vengjilla e Lindjes se Shen Marise; Sozondi, Dësh-mori i Shenjte.*

8. *Lindja e Shen Marise.*

#### PERLESHORJA E SHEN MARISE, T. IV.

Lindja jote o Hyjlíndese, gezój e ndriti tere njerezine, se prej teje lindi Díelli i Drejtesise, Krishti Perendia yne, qe zgjidhi mallkimin, dhe na dha bekimin, dhe aboliti vdekjen, dhe na falí jeten e ameshuar.

#### THIRRTORET, T. I, TON URANION

Shen Joakimi dhe Anna sot kanë panair, se lintne kryenisjen e ndriçimit te botes, Hyjlíndesen e vetem Zonjen Marí, qe kremtojme me bes' e mall, qe prej Jesseut ka mbire çuditerisht, per shpetimin e besnikëve.

Prej Annes lindi Maria Zonja Hyjlíndese, dhe Nena Virgjereshe per shpetimin e botes, prej saj çuditerisht na lindi Jesúj, Shpetimtár' i besnikëve, per te spastruar mekatin stergjysherór, te Adamit te qemóteshme.

Maria Nena e Shenjte e Zotit Jesú Krisht, lavdia profetike dhe e bij' e Davidit, ka lindur sot per boten çuditerisht, edhe rritet prej prínderve, Shen Joakimit dhe Annes me bes' e mall, per shpetimin e besnikëve.

LAVDI DHE TANI, T. T. II. Ejani o besnikë, prisni me besë dhe mall, kuroren e virgjeresë, bu-

rimin e jetes, ferren e zjarrit te pasosur, qe ndri-  
ti shpirtet tona.

### PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Ejani tok ketú, dhe bijen e Davidit, qe lindi Je-  
sú Krishtin, Hyjlíndesen e Shenjte, Marine lav-  
derójeni.

Zotin qe na çlirój, me anen e beronjes, dhe na  
dhuroj Marine, Hyjlíndesen e vetem, me kenge  
perhymnójeni.

Sot ardhi gas kudó, ne tere njerezine, se lindi  
prej Shen Annes, Maria Virgjeresha, e vétemja  
Hyjlíndese.

LAVDI DHE TANI. Ejani beserisht, kendoni  
Shen Marine, qe lindi prej Shen Annes, edhe  
Shen Joakimit, per hirin e besníkeve.

### NDENJESORET, T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Eja thirr David Profét, ç' bé te ka bere Zot' i  
Math? Gjitható qe me premtój, ja taní thote mi  
mbarój, se na dhurój Virgjreshen nga fara e  
brezit tim; dhe lindi prej asáj, Krishti Adami i  
ri, nje Mbret dhe Perendí, dhe nje lavdí per fron-  
nin tim, dhe mbreterón perhere mi nje fron te  
patundur. Beronja lindi, Marín' e Shenjte, Krye-  
zonjen Hyjlíndese.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

Prej Jesseut lulezój, dhe prej Davidit na burój,  
Zonj' e Virgjjer Shen Marí, sot na ka lindur per  
shpetím, dhe perseritet bota dhe bekohet prej  
Perendise. Brohoritni pra me gas, o qell dhe toke  
bashkerisht, lavderójeni kudó, popuj dhe kombe

permi dhé, se Joakimi defrén edhe Shen Anna gezohet. Beronja lindi, Marín' e Shenjte, Kryezonjen Hyjlíndese.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

#### T. T. IV. TO PROSTAKTHEN

U-ngazelloft' e defræfte tere dheu, se ja qell' i Zotit Krisht mi dhene lindi, Kryezonja dhe Nena e Perendise. Beronja, foshnje ka Zonjen Shen Marí; gezohet, per lindjen plaku Shen Joakím: Pema thote ka lindur sot, dhe prej asáj lulezón, prej renjes se Davidit Jesúj. O çudí e maníçime.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

#### SHKALLESA KREMTORE, T. IV.

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartesohe ne paqesi, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARÇVARGU. Do ta kujtónj emrin tent ne gjithë brezat e brézave.

#### UNJILLI I MENGJEZIT PAS LUKAJT

M' até dite, Mariama u-ngrit, edhe vajti me nxitím ne malesí, ne nje qytét te Judese, dhe hyri ne shtepine e Zaharise, dhe e pershendoshi Eli-

sabeten. Dhe posa e degjój Elisabeta pershendoshjen e Marisë, keceu foshnja ne barkun e saj. Dhe Elisabeta, e frymesuar prej Shpinit të Shenjtë, thirri me ze të math, edhe tha: “E bekuar je ti ne mes të grave, dhe e bekuar është pema e barkut tënt. Dhe si me ngjau kjo lumeri, që e jema e tim-Zoti të me vizitonje? Se ja, posa me tingëlliu ne veshet pershendoshja jote, me keceu foshnja ne barkun me ngazëllim. Dhe lum ajó, që ka besuar, se do të permbushen fjalet, që janë thënë prej Zotit për atë.” Dhe Mariama tha: “Madheshtoje Zotin, o shpirti im, edhe ti, o mendja ime, ngazellohu mi Perëndine, Shpetimtarin tim; se e hodhi syrin mi shërbetoren e perunjur; se ja që-tani e tutje gjithë brezat do me lumërojnë; se me madheshtój i Fuqishmi, dhe emri i tij është i shenjte.” Dhe mbeti Mariama bashkë me atë nja tre muaj, dhe pastaj u-kthye ne shtëpinë e vetë.

*Pastaj thuhet Psalmi 51 pa ze dhe menjehere:*

LAVDI. Me nermjetimet e Hyjlindëses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlindëses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

*Meshirome, o Perëndi, meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.*

T. T. II. Kjo është dita e Zotit, ngazëllóhuni o popuj, se lindi drita dhe libra e Fjalës, dhe tēmpulli i Kryepriiftit, edhe Shpetimtarit tonë Jesú Krisht, për shpetimin e shpírteve tona.

## SHKURTORJA, T. IV.

*Kjo Shkurtore kendohet ne Meshe pas Hyrjes se Vogel qe me 14 te Gushtit gjer me 12 te Shtatorit. Pas kesaj date kendohet Shkurtorja e Kryqit.*

Joakimi dhe Anna qe nuke kishin femije, dhe Adami dhe Eva qe ishin shtypur prej vdekjes, fituan gas dhe liri me ty, kur linde o Hyjlindese. Até po kremtojme né besniket, se taní u-çliruum nga mekati dhe thomi: Beronja lindi Hyjlindesen edhe Nenen e Zotit Krisht.

## SHTGPIA

Lutjet edhe psheretimet e Shen Joakimit edhe te Shen Annes u-mirepritne prej Zotit ne qell, edhe mbiu ne bote pema jeteprúrese, edhe beronja lindi Hyjlindesen dhe Nenen e Zotit Krisht.

## SINAKSARI

Me tete te ketí múaji, kujtojme Lindjen e Kryezonjes sone se Permishenjtc, Hyjlindeses dhe gjithenjé Virgjereshes Marí.

Gjithe sot, te dy vellézcrit e shenjtc, Rufi dhe Rufini, mbaruan jeten te vrare me shpate.

Gjithe sot, Shen Severi mbarój jeten i vrare me shpate.

Gjithe sot, Shen Artemidori mbarój jeten i djegur ne zjarr.

Me nermjetimet e tyre, o Perëndí, meshiro-na, Amín.

*Pastáj thuhen Zbritesoret e Kryqit:*

ZBRITESORET E KRYQIT, T. T. IV,

STAVRON HARAKSAS

I. Nje Kryq vijosi me shkop, Moisi Profeti,

dhe Det' i Kuq u-ça me dysh, dhe Israeli shkoj pçrtéj; pastáj prapç e bashkój, me nje tjater shkop dhe Kryq, persiper vâlave, dhe forcat edhe qeret, Faraonit ia mbyti; pra Krishtin kendojme si Perendí dhe Zot, me brohorí dhe gas.

III. Shkopi njhere, si nje simból i misterit na u-çfaq; se filizat na treguan prifterine, edhe per Kishen beronje, ja ku mbiu edhe lulczój, Kryqi taní, per force dhe per shigurím.

IV. Kam degjuar o Zoti Krisht, si e regullove keté mistér te math, kupetova veprimin tent, dhe te lavderova Perendia im.

V. O Drur' i lumur tri here, permi te cilin undé, Mbret' i larte Zoti Krisht, se prëj teje u-rezua djalli gjarper, i genjyer tmerrçrisht, prej Zotit te mberthyer permi Kryq, q' u fal shpírteve, perdellím dhe paqe gjithenjé.

VI. Ne barkun e bishes se detit, Profeti Shen Joná, dúarte i zgjerój ne forme Kryqi, dhe pesimin e Krishtit partregonte kjarísht, pra i tridicim jasht' u-hoth, dhe lajmen e perminatýreshme e parclajmerój, te Jesújt te mberthyer permi Kryq per né, qe na e ndriti krijesen, me ngritjen prej vârreve.

VII. Urdher te çmendur dha, tirani beselík, e tundi pópullin, boten e tmerrój, me blasfemí dhe paudhesí, po te Tre Djemat nuk i tronditi dot, terbimi i eger, as furra me zjarr; dhe kur u fryri era veseprúrese, kendonin brenda mun ne zjarr: I

perhymnuar je, Perendí dhe Zot i Math, për jetë të bekuar.

VIII. E bekoní djema, si Trinia nga númeri, Atin qëllor të vétëmin Zot, hymnoni Fjalën që mi dhënë zbriti, dhe e bëri veshë zjarrin e fúrrave; dhe e lartësoni, dhe Shpirtin e Tereshenjtes, që u dhuróje që të gjithëve jetën.

*Ne Madheshtimet këndohen të dy Irmonjtes pasonjes në T. II:*

Ty që ke lindur për botën, Perendinë tonë Zotin Krisht, Shpetimtarin tonë Jetëdhënësin, të mishëruar çuditërisht, me një mistër të Shpirtit Shenjt, o e bekuar Shenë Mari, o Virgjëreshë dhe Hyjlíndëse.

E huaj për nënat është virgjëria, edhe për virgjëreshat femijelíndja, po me ty që të dyja, o Shenë Mari u-kombinuan. Për gjithë kombet përmi dhë kudo, të madheshtojnë pa pushim.

*Pastáj thuhet Kenga IX e Zbitesores në T. T. IV:*

IX. O Hyjlíndëse Parajse mistike je, se pa lërim lulçovë Zotin Krisht, që mbolli përmi dhë, jetëpruresin Kryq, që po lusim me beshë, se ky po lartësohet, dhe me anën e tij, ty të madheshtojmë sot.

## DËRGIMËSORET, T. II, TIS MATHITES

Në tërë botën përmi dhë, të gjithë ngazellohen, o Zonjë dhe Hyjlíndëse, Nëne dhe Virgjëreshë, për lindjen tënde të shenjtes, nus' e panusëruar, dhe i gëzovë prínderit, të helmuar prej vjetësh

qe mbanin zi, nga mjerimi i pafemijesise, dhe i shpetove njerezit, nga mallkimi i Eves.

Stergjysher ngazellohuni, o Eve madheshtohu, Profete vallezeni tok, me Apostujt' e Shenjte, e dhe me gjithe Deshmoret, sot po gezohet gjindja, e Engjejeve dhe njeresve, lart ne qell dhe mi dhene ka brohori, se prej Joakimit edhe Shen Annes, na lindi Zonja Shen Mari, per shpetimin e botes.

LAVDERIMET, T. T. IV, O TU PARADOKSU.

Ç' eshte kjo çudi dhe kjo habi! Ti o burim jete-sor, prej beronjes na linde sot, dhe nis qe-tani dhe sjell, perdellim edhe hir per ne. Pra ngazellohu, ti o Shen Joakim, se ti u-bere, At i Hyjlindeses: S' ka tjater prind si ty, qe ke mbajtur Shen Marine ne peqi, Nenen e Jesujt me nam, qe na shpeton gjithenje.

Ç' eshte kjo çudi dhe kjo habi! Prej nje beronje na lint, se ashtu Perendia tha, Krijetari lart ne qell, Zot i Math i te gjitheve. Dhe u-gezua, Anna e Shenjte sot; nena keceni, dhe pergezoheni. Ti je m' e lumura, nga te gjitha grat' e botes permi dhe, Zoti eshte tok me ty, se ti shpetimin na sjell.

Shtylle shpirtore me lavdi, dhe en' e qellshme je, qe po ndrit dhe shkelqen me hir, o Shen Ann' e ndercime, se na linde Hyjlindesen, dhe Kryezonjen, lulen e hycshme, dhe Virgjreshen, e lumeruarshme, shembell te vajzave, qe i kane virgjeresaj zili, dhe u fal besnikeve, ndjese dhe perdellim.

LAVDI DHE TANI, T. T. II. Kjo është dita e Zotit, ngazellóhuni o popuj, se lindi drita dhe libra e Fjalës, dhe témpulli i Kryepřiftit, edhe Shpëtimtari tonë Jesú Krisht, për shpëtimin e shpirtëve tona.

### HYRTORJA

Shpëtona o i Bir' i Perëndisë, i çudiçim nër Shenjtoret, né qe të kendojmë Alilluia.

### SHKURTORJA, T. IV, IOAKIM KE ANNA

Joakimi dhe Anna qe nukë kishin femijë, dhe Adami dhe Eva qe ishin shtypur prej vdekjes, fituan gas dhe lirí me ty, kur linde o Hyjlíndese. Atë po kremtojmë né besnikët, se taní u-çliruam nga mekati dhe thomi: Beronja lindi Hyjlíndesen edhe Nenen e Zotit.

### APOSTULLI

Madheshtoje Zotin, o shpirti im. Se e hodhi syrin mi shërbetoren e përunjur.

Prej Letres së Palit për Filipianët.

Vellezer, kini atë frymë, qe ka patur Jesú Krishti, i cili kishte formën e Perëndisë, dhe ishte barabár me Perëndinë, po e zbriti veten e tij aqë sa mori formën e shërbëtorit edhe shëmbëllsine e njeriut, edhe u-çfaq si njerí nga fytyra, dhe e përunji veten e tij, edhe u-tregua i bindur gjer në vdekje, dhe në vdekje mi Kryqin. Përandáj edhe Perëndia e lartësój, edhe i dha një emer përmi çdo emer tjetër, qe përpara atí të përğunjen të gjithë atá, qe janë në qell edhe mi dhé edhe nënë dhënë, edhe çdo gjuhë të refenjë se Jesú

Krishti është Zot për lavdime e Perëndisë dhe Atit.

### UNGJILLI PAS LUKAJT

M'atë kohë, Jesúj hyri në një katúnt, edhe një grua, e quajtur Martha, e priti në shtëpinë e vetë. Dhe ajo kishte një motër, të quajtur Maria, e cila ndenji në kembet e Jesújt, edhe dëgjonte fjalët e tij. Po Martha sillej rotull, dhe shërbente rëndë, pastaj qëndroj, edhe tha: "O Zot, valle nukë të ha malli që ime-motër më ka lënë të shërbënj e vetem? Thuaj-i, të lutem, të më ndihmonjë." Dhe Jesúj u-përgjëq, edhe i tha: "Martha, Martha, po kujdesesh edhe trumbullohesh për shumë gjëra, po vetem për një gjë është nevojë; dhe Maria ka zgjedhur pjesën e mirë, e cila nukë do të rëmbëhet prej saj." Edhe kur po i thoshte këto fjale, një grua prej pópullit e ngriti zerin, edhe i tha: "Lum' barku, që të ka mbajtur, edhe siset, që ke thëthitur." Po ai tha: "Jo, po lum' atá, që e dëgjojnë fjalën e Perëndisë, dhe e rúajne."

### MADHËSHTIMI I MESHËS, T. II.

E huaj për nënat është virgjëria, edhe për virgjëreshat femijelindja, po më ty që të dyja, o Shen Mari u-kombinuan. Pra gjithë kombet përmi dhë kudó, të madhështojnë pa pushim.

### KUNGATORJA

Do ta marr kúpen e shpëtimit, edhe do ta përthërrës emrin e Zotit.

9. *Joakimi dhe Anna, Hyjprínderit e Shenjte dhe të Drejte; Severiani, Dëshmori i Shenjte.*

## PERLESHORJA E HYJPRINDERVE, T. II.

O Hyjprinder të Shenjta, që ju kremtojmë me besë, nermjetoni pranë Zotit, të shpëtohen shpirtet tona.

10. *Menodora, Metrodora, dhe Nimfodora, Deshmoret e Shenjta.*

11. *Shen Theodora e Aleksandrise, Nena jone Oshe-náre.*

## PERLESHORJA E SHEN THEODORËS, T. T. IV, EN SI MITER AKRIVOS

Ti o Nënë pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, së e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mësim, që të kujdësemi për trup, se shkon me nxitim, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gezohet tok me Ɖngjejte, o Theodór' e Shenjta lavdí me ty.

12. *Aftonomi, Hierodeshmori i Shenjta.*

13. *Dedikata e Kishes së Ngjalljes së Zotit tone Jesú Krisht; Vengjilla e Lartesimit të Kryqit; Korneli Kryeqindesi, Hierodeshmori i Shenjta.*

## PERLESHORJA E DEDIKATËS, T. IV.

Me atë shkelqim që ndrite qellin lart, me atë lavdí dhe drite ketú zbukuroje sot, Kishen tendë të Shenjta o Kryezót. Forcoje për here në jetet e jetes, dhe lutjet tona prit, që të drejtojmë me besë, me nermjetimet e Hyjlíndeses, ti o jeta dhe ngjallja e të gjítheve.

PERLGSHORJA E SHEN KORNELIT, T. IV,  
EPEFANIS SIMERON

Prej pagáneve Deshmór, i pari dolle, edhe Kishen me shkelqím, e zbukurove bescrisht, me verime plot me virtút, o kryeqindes hyjprures o Shen Kornél.

14. *Lartesimi i Kryqit.*

PERLGSHORJA E KRYQIT, T. I, SOSON KIRIE

Ti shpctoje Zot, edhe ti bekoje pópullin, edhe trashegimin tent. Mundjen edhe triumfin, dhurona kunder barbáreve, edhe rúajna shtetin, me poteren e Kryqit tent.

THIRRTORET, T. T. II, OLIN APOTHEMENI

Kryqi lartsohet sot, prej Krishtit te kryqesuar, dhe pesimin shpetimtár, e hymnojne njérezit bescrisht kudó; me até e permbýs, Djallin edhe vrásesin, dhe nga vdekj' e zece po na ngjall, na zbukurón me hir, dhe na vlercsón te gatítemi, per Mbreterín' e qíellit, si i zemerdhempshur meshireplót; pra te ngazelluar, e lartsojme emerin e tij, dhe madheshtojme me brohorí, zbritjen njeridáshese.

Moisiu te shenój, me duar ngritur perpjete, e dermój e shtypi krejt, Amalík tiranin o i çemuar Kryq; çdo besnik ti e mburr, çdo Deshmór ti e mpron, Apostujte ti i lavderón, shqyt i te dréjteve, dhe shpetím i gjith' Oshenáreve; pra ty te lartesuvar sot, te shikón kriesa me ngazellím; dhe

me panairë, Jesunë Shpetimtár e lavderón, që mirësinë na e tregóji, dhe të ndarat i bashkóji.

O i lartësuar Kryq, që t' adhurojnë me frikë, ushterít' e ƒngjehjeve, sot që lartësohesh prej Zotit me shkelqím, lart e ngre çdo njerí, mekatár me mallkím, dhe të gjithë né të dbúarit, dhe të denúarit, nga mekat' i par' i stergjýsherve; me mall të pershendoshim pra, dhe bekím kerkojme dhe shenjterím, me thirrje dhe klithma: Bekóje-ni Jesunë Perendí, me lavderime megjúnjazi, fá-luni përpara tij.

LAVDI DHE TANI, T. II. Ti gjithënjé na mpron, nga çdo rezík i jetës, nga grackat e armikut, Satanit të pabesë, o Kryq i Shenjt' i Zotit Krisht.

PASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum' ti o jetëprúresi Kryq, o i pamundur, flamur i besmírëve, o portë e Parajsës, që ngazellón çdo besník, ti që Kishen tendë reth me mur e mpron; prej teje u-badërdís, u-dermua për gjithënjé, forca e vdekjes, u-përpí edhe krejt u-çduk, dhe u-ngritme né, që prej dheut në qiëllin. Arm' e pakundershtúarshme, armík i demóneve, lavdí e çdo Oshenari, dhe zbukurím i Dëshmóre-ve; limán i shpetimit, që i fale tërë botes, meshirë dhe shpetím.

Lum' ti o Kryq i Zotit Jesú, që ke larguar, çdo mallkím njerczór prej nesh, o shenj' e vertét' e gazit, që po tmerrón çdo armík, kur po lartëso-

hesh me nderime sot; o ndihm' e te gjitheve, shigurimi i mbréterve, forc' e prifterinjve, bukurí' e te dréjteve, i shenúari, dhe nga tmerr' i shpetúari; o shkop i gjithë fórcave, prej teje po mpróhemi, o arm' e paqes per friken, qe adhurohesh prej Engjejve; lavdia e Krishtit, qe i fale tere botes, meshire dhe shpetím.

Lum' ti qe ndrit per çdo verberí, dhe te scmu-ret, i sherón dhe te vdékurit, te gjithë i ngre nga varret, qe na ke ngritur dhe né, te rezúarit poshte i çemuar Kryq; prej teje u-çakerdís, forc' e vdekjes dhe lulczój, pavdeksia, dhe njeriu u-ngjit ne qell, dhe Satan' i keq, u-dermua me gjitheséj. Sot qe po lartsohesh ti, prej gjithë Peshkópeve, e lartsojme me bese, te lartcsúarin permi ty; dhe ty t' adhurojme, qe i fale tere botes, meshire dhe shpetím.

LAVDI DHE TANI, T. II. Ejani me gezím, te gjithë te Krishteret, dhe Kryqin e çemuar, ku u-mberthye Krishti, me bese pershendósheni.

### NDENJCSORET, T. I, TU LITHU

Sot Kryqin adhurojme o Zot i zemerdhempshur, se permi até u-mbertheve, ti o jeta e botes. Parajsen pra ia çel Shpetimtár, Kusarit te pen-duar beserisht, dhe per gas e vleresove posa te tha: Kujtome o Zot i larte. Pritna dhe né si até; se po te therresim si aý; ndjena mekatat me dhempsherí, i vetem njeridashes.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

T. T. II. Kur u-ngrit perpjete Kryqi yt o Krisht, u-tronditne themelít' e vdekjes; se Ferri e leshój i tmerruar, até qe gelltiti si i pangopur; na tregove udhen e shpetimit, pra te lartesojme dyke thirrur: O i Bir' i Perendise meshirona.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

T. T. IV, TO PROSTAKTHEN MISTIKOS

Shenjen e Kryqit fáqeza parëtreonte, Jesú Naviu kur leftonte me armiqtë, kur i ngriti perpjete dúarte per kryqi; dhe djellin, e qendrój gjer oren qe i shoj; armiqtë, qe leftonin Zotin e Math, dhe tani gjithaý u-err, mi Kryqin kur te shikój, kur Ferrin e dermove krejt, dhe i ngjalle te vdëkurit.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

SHKALLESA KREMTORE, T. IV.

Qe prej djalcrise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zottit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartësohet ne paqesí, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vadinin tere kriesen per jetelindje.

PARCVARGU. Te gjitha anet e dheut e kane pare shpetimin e Perendise song.

## UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS JOANIT

Zoti tha: “Atë, lavderoje emrin tënt.” Edhe një zë u-degjua prej qiellit: “E kam lavdëruar, dhe do ta lavdëronj perserí.” Edhe gjindja, që e degjój, thoshte se u-bë bumbullimë. Disa të tjerë thoshnin se i foli një Engjell. Edhe Jesúj u tha: “Ky zë nukë ardhi për mua, po për ju. Taní po bëhet gjyqi i kesáj bote. Taní princi i kesáj bote do të hidhet jashtë. Dhe unë, posa të ngrihem nga dheu, do t’ i heq të gjithë pas vetes sime.” Dhe këtë e thoshte për të treguar me ç’farë vdekje kish për të vdekur. Edhe gjindja i tha: “Në kemi degjuar nga ligja se Krishti mbetet për jetë. Qysh pra ti na thua që duhet të ngrihet lart i Biri i njeriut?” Edhe Jesúj u-pergjéq: “Edhe pak kohë është drita bashkë me ju. Barisni sa kini driten, që të mos ju zërrërrësira, se aý, që barët në ërresirë, nukë di se ku vete. Taní që kini driten, besójëni driten, që të bëheni bij të drites.”

*Pas Ungjillit këndohet pa zë:*

Passi pamë Ngjalljen e Krishtit, le t’ i fálemi Zotit të Shenjtë Jesú, të vétëmit të pamëkatmë. Adhurojmë Kryqin tënt, o Krisht, edhe hymnojmë dhe lavdërojmë Ngjalljen tënde të Shenjtë, se ti je Perëndia ynë, veç teje nukë njohim tjetër Perëndí, dhe emrin tënt po e emërojmë. Ejani të gjithë, o besnikë, ta adhurojmë Ngjalljen e Shenjtë të Krishtit. Se ja, me anën e Kryqit ka

ardhur gezím ne tërc boten, se dyke duruar Kryqin, e dermove vdekjen me vdekje.

*Psalmi 51 pa ze.*

*Pastáj kendohen Troparet pasónjese ne T. II:*

LAVDI DHE TANI. Ti gjithenjé na mpron, nga çdo rezík i jetes, nga grackat e armikut, Satanit te pabese, o Kryq i Shenjt' i Zotit Krisht.

*Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.*

T. T. II. O Kryq i Krishtit, o shpres' e te Krish-téreve, udhheqes i te arratísurve, limán i dime-rónjesve, triumfi i lúfteve, shiguri' e botes, mjeku i te semúreve, ngjallja e te vdékurve, kij meshire per né.

### SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHIS

*Kjo Shkurtore kendohet ne Meshe pas Hyrjes se Vogel qe me 13-21 te Shtatorit.*

Ti qe u-ngrite permi Kryqin dyke dashur, shtetit te ri te themeluar prej teje, dhuroji kurdohere hir o Krisht Perendí, ep-i force dhe gezím, pópullit dhe shtetit tone, fal-i mundje dhe triúmfi, ne çdo lufte mi armiqte; te paçim gjithenjé bashke-luftár, arme per paqe, tropé te pamundur.

### SHTËPIA

Shen Pali, qe u-ngrit ne qíellin e trete dhe ne Parajse, u shkruan Gallatiáneve: "Po une nuke dua te mburrem veçse me Kryqin e Zotit tone Je-

sú Krisht.” Pra, e paçim gjithenjë bashkeluftár, arme për paqe, tropé te pamundur.

### SINAKSARI

Me katermbedhjetë te ketí múaji, kujtojmë Lartësimin e Kryqit të çemuar dhe jetëbërës.

Gjithë sot, kujtojmë fjetjen e Shen Joanit Gojarte, Kryepeshkopit të Kostandinopojës.

Gjithë sot, kujtojmë fjetjen e Mbretëreshës Plakilla, së shoqes së Theodosit të Math.

Gjithë sot, kujtojmë Aterit e Shenjtë, që umblotnë në Sinodin Ekumenik të Gjashtë, në kohen e Mbretit Kostandin Pogonatit.

Gjithë sot, kujtojmë Papën, Dëshmorin e Shenjtë.

Gjithë sot, Theokliu, Dëshmori i Shenjtë, mbaró jeten i vrarë me shpatë.

Gjithë sot, Shen Valeriani i vogël, mbaró jeten i vrarë me shpatë.

Me nermjetimet e tyre, O Perendí, meshirona. Amin.

### ZBRITËSORET, T. T. IV, STAVRON HARAKSAS

*Ketó Zbritesore kendohen që me 1 gjer me 13 të Gushtit, edhe pastáj prapë që me 22 të Gushtit gjer me 21 të Shtatorit.*

I. Një Kryq vijosi me shkop, Moisi Profeti, dhe Det' i kuq u-ça me dysh, dhe Israeli shkoj përtej; pastáj prapë e bashkó j, me një tjetër shkop dhe Kryq, persiper vâlave, dhe forcat edhe

qeret, Faraonit ia mbyti; pra Krishtin kendojme si Perendí dhe Zot, me brohorí dhe gas.

III. Shkopi nje here si nje simból i misterit na u-çfaq; se filizat na treguan prifterine, edhe per Kishen beronje, ja ku mbiu edhe lulezój, Kryqi taní, per force dhe per shigurím.

IV. Kam degjuar o Zoti Krisht, si e regullove keté mister te math, kupetova veperimin tent, dhe te lavdetrova Perendia im.

V. O Drur' i lumur tri here, permi te cilin undé, Mbret' i larte Zoti Krisht, se prej teje u-rezua djalli gjarper, i genjyer tmerrersht, prej Zotit te mberthyer permi Kryq, q' u-fal shpírteve, perdellím dhe paqe gjithenjé.

VI. Ne barkun e bishes se detit, Profeti Shen Joná, dúarte i zgjerój ne forme Kryqi, dhe peshimin e Krishtit paretrgonte kjarisht, pra i tridicim jasht' u-hoth, dhe lajmen e perminatýreshme e parelajmerój, te Jesújt te mberthyer permi Kryqin per né, qe na e ndriti kriesen, me ngritjen prej várreve.

VII. Urdher te çmendur dha, tirani besclík, e tundi pópullin, boten e tmerrój, me blasfemí dhe paudhesí, po te Tre Djemat nuk i tronditi dot, terbimi i eger, as furra me zjarr; dhe kur u fryri era vesçprúrcese, kendonin brenda mun ne zjarr: I perhymnuar je, Perendí dhe Zot i Math, per jete i bekuar.

VIII. E bekoni djema, si Trinia nga númeri, Atin qellór te vétemin Zot, hymnoni Fjalën qe mi

dhenc zbriti, dhe e beri vese zjarrin e fúrrave; dhe e lartesoní, dhe Shpirtin e Tereshenjtc, qç u dhurój qç te gjithëve jeten.

*Ne Madheshtimet kendohen Troparet pasónjese:*

IX. O Hyjlíndese Parajsc mistike je, se pa lerím lulezove Zotin Krisht, qç mbolli permi dhé, jetepnúresin Kryq, qç po lusim me besc, se ky po lartesohe, dhe me anen e tij, ty te madheshtojme sot.

Mallkím' i vjeter i stergjyshit, qç rodhi nga farmaqi i gjárperit, u-abolít me Kryqin e Zotit Krisht; bekimi ardhi prapc per njerine me Marí Hyjlíndesen, qç na lindi Jesúnc çlirónjesin; te gjitha pra fuqite, e lavderojne ne qíellin.

## DERGIMCSORET, T. II.

O Kryq o gardián i botes se tere, o Kryq o bukurí e Kísheve tona, o Kryq shigurimi i mbréterve, o Kryq o mprojtj' e besníkeve, o Kryq lavdí e Çngjcejve, dhe tmerri i demóneve.

Ja Kryqi lartesohe sot, se Krishti jetedhénesi, mbreti i fronesuar, me Atin edhe me Shpirtin, mi até u-mberthye, dhe ndrity gjithc njérezit, per te njohur te drejten kudó mi dhé, dhe u fali jeten e ameshuar, dhe Mbreterín' e qíellit, dhe driten e Parajscs.

## LAVDERIMET, T. T. IV, O TU PARADHOKSU.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Ja jetepnúresi dru, Kryq' i Shenjte i Zotit Krisht, po ngrihet me

lavderím, dhe kremtohet me lartésím; e lavde-  
rojnë anet e áneve, dhe po tmerrohet tuf' e de-  
móneve; o ç' fare dhuretí, është kjo për njërezit  
me té o Krisht, shpirtet tona i shpetó, o i meshí-  
reshme.

Ç' është kjo çudí dhe kjo habí! Si rush të kuq  
jetepiót, e ka mbajtur të Lartin Zot, me gozhda  
mi dúarte, Kryq' i Shenjte që ngrihet sot; kështú  
na hoqi, Zoti në gji të tij, dhe u-dermua, vdekja  
me gjitheséj; o Kryq i Zotit Krisht, që na shpie  
në Parajsen lart në qell, dhe pavdekésí na jep,  
lavdí me ty o Zot.

Ç' është kjo çudí dhe kjo habí! Kryqi zgjerón  
edhe zgjat, dhe arrín gjer në qiéllin, se me hir të  
hýjeshme, tërë botën e shenjterón, me té dermo-  
hen, kombët e égëra, me té forcohen, fronet e  
mbréterve. O shkall' e hýjeshme, me të cilën ngjí-  
temi në qellin lart, dhe kendojmë bescrísht. Lav-  
dí me ty o Krisht.

LAVDI DHE TANI, T. T. II. Sot na vjen për-  
para Kryqi i Zotit, edhe besnikët e presin me  
mall, edhe marrin shërimë për shpirtin edhe për  
trupin edhe për të gjitha lengatat. Le ta përshen-  
doshim me gas edhe me frikë: Me frikë, se jemi  
të pavyer nga mekakat; me gas, se Zoti Krisht i  
kryqësuar i fali botes meshiren dhe shpëtimin.

## HYRTORJA

Lartésójeni Zotin Perëndinë tonë, dhe adhuró-  
jeni mëgjúnjazi se është i shenjte. Shpëtona o i

Bir' i Perendisë, që u-kryqesove trupcrisht, né që te kendojme Alilluia.

### SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHS

Ti që u-ngrite permi Kryqin dyke dashur, shtetit të ri të themeluar prej teje, dhuroji kurdoherc hir o Krisht Perëndi, ep-i forcë dhe gezim, pópullit dhe shtetit tonë, fal-i mundje dhe triúmf, në çdo luftë mi armiqte; të paçim gjithenjë bashke-luftár, armë për paqë, tropë të pamundur.

*Ne vent të Trishenjtit këndohet:*

Kryqit tent po i fálemi o Kryezót, dhe Ngjalljen tendë të Shenjtë lavderojme.

### APOSTULLI

Lartësójeni Zotin Perëndinë tonë. Zoti mbretëroj, le të zemërohen pópujtë.

Prej Letres I së Palit për Korinthianët.

Vellezer, fjala e Kryqit është marrësi për të húburit, po është fuqi e Perëndisë për të shpëtuarit. Se është shkruar: “Do ta húbás urtesinë e të úrteve, dhe do ta çkaterrónj mendjen e të ménçurve.” Ku është i urti? Ku është shkrónjesi? Ku është bisedónjesi i kesáj jete? Vallë Perëndia nuk e marrosi urtesinë e kesáj bote? Se posa bota nuk e njohu Perëndinë me urtesinë, Perëndia i shpëtój besniket me marrësinë e leçitjes. Se Judenjtë kerkojnë shenja, dhe Elinet kerkojnë urtesí, po né leçitim Krishtin e kryqesuar, i cili është një shkandull për Judenjtë dhe një marrësi

per Elinet, po per né te ftúarit, Judénj edhe Eline, eshte fuqia dhe urtesia e Perendise.

## UNGJILLI PAS JOANIT

M' até kohë, Kryeprifterinjtë dhe pleqtë bene keshille që ta humbisnin Jesusë. Dhe i vajtin Pillatit, edhe i thanë: “Kryqesoje, kryqesoje.” Edhe Pillati u-pergjéq: “Mërreni ju vetë dhe kryqesójeni, se unë nuk i gjenj nonjë faj.” Edhe Judenjët i thanë: “Né kemi ligjen, dhe pas ligjes sonë duhet të vdesë, se e bëri veten Bir të Perendisë.” Pillati, kur e degjój ketë fjale, u-tremp më tepër, dhe hyri perserí në pretoren, dhe i tha Jesúsjt: “Nga je ti?” Po Jesús nuk i dha asnjë pergjigjie. Pillati, pra, i tha: “Mua nukë me flet? Nukë di që kam fuqí të të kryqesónj, edhe kam fuqí të të çlirónj?” Edhe Jesús iu-pergjéq: “Nukë do të kishe patur asnjë fuqí kunder meje, po të mos të ishte dhënë se larti.” Pillati, pra, kur i degjój ketó fjale, e pruri jashtë Jesúsë, dhe ndenji mi tribunën në një vent, të quajtur Gur-shtruar, edhe Hebraisht Gabbathá. Edhe ishte e Premtja e Pashkës, edhe ora nja gjashtë. Edhe u tha Judenjve: “Ja mbreti juaj.” Po atá bertitnë: “Mërrë, mërrë, kryqesoje.” Pillati u-pergjéq: “Mbretin tuaj ta kryqesónj?” Edhe Kryeprifterinjtë i thanë: “Nukë kemi tjetër mbret përveç Qesarit.” Atchere ua dorëzój që ta kryqesonin. Dhe e múarnë Jesúsë, dhe e shpunc tutje. Dhe dyke mbajtur Kryqin e vetë, arriu në një vent, të quajtur

Kallvár, Hebraisht Golgothá. Atjé e kryqesuan me dy te tjerë tok, andéj dhe ketéj edhe në mest Jesúnc. Dhe Pillati shkrojti një titull, dhe ia vuri mi Kryqin me ketó fjale: **“Jesú Nazaréasi Mbreti i Judenjve.”** Edhe shume prej Judenjve e kenduan keté titull, se vendi, ku u-kryqesua Jesúj, ishte afer qytetit. Edhe titulli ishte shkruar hebraisht, elinisht, edhe latinisht. Edhe prane Kryqit te Jesújt po qendronin e-jema dhe e motra e s’emes, Maria e Kleopes, edhe Maria Magdalena. Jesúj, pra, kur e pá t’ emen dhe dishépullin e dashur atjé prane, i tha s’ emes: “Moj grua, ja yt bir.” Pastáj i tha dishépullit: “Ja jot’ emë.” Dhe qe até ore dishépulli e mori në shtepinë e vetë. Pastáj, Jesúj, dyke ditur se qe te gjitha ishin mbaruar, epi kryet, edhe dha shpirt. Edhe Judenjtc, qe te mos mbéteshin kufomat mi Kryqin te Shtunen, se ajó e shtunë ish e madhe, iu-lutne Pillatit qe tua thýenin kercinjtc, dhe t’ i zbrisnin nga Kryqet. Arthne, pra, ushtaret, edhe ua thyen kercinjtc atyre, qe ishin kryqesuar bashkë me Jesúnc. Po kur i vajtin Jesújt, edhe pane qe aý kishte vdekur, nuke ia thyen kercinjtc, po një prej ushtáreve ia çpoj brinjen, dhe menjehere i rodhi gjak edhe uje. Dhe aý, qe e ka parë, desh-mój, dhe desh-mimi i tij esht i vertete.

#### MADHESHTIMI I MESHES, T. T. IV

O Hyjlíndese Parajsc mistike je, se pa lerím lulçzove Zotin Krisht, qe mbolli permi dhé, jete-

prúresin Kryq, qe po lusim me besë, se ky po lartsohet, dhe me anen e tij, ty te madheshtojme sot.

## KUNGATORE

Drita e faqes sate u-shenua mi né, o Zot.

### ADHURIMI I KRYQIT

*Pas Doksollogjise, ose pas Meshes, dyke kenuar Hymnin Trishenjtór, ngadale behet Hyrja e Kryqit te Çemuar keshtú: Prifti meshonjes qendron perpara Alltarit te Shenjte, dhe e temjanis Kryqin e Çemuar, pastáj e ve mi krye me nje dhisk me dege besiloku, dhe del jashte nga porta veriore, dyke patur perpara Skifteret edhe Psállterit edhe Dhjákerit, keshtú e siell Kryqin ne mes te Kishes, ku eshte nje tryeze e stolisur, dhe passi e rotullón tri here, qendron nga lindja, dhe thote me ze te larte:*

**PRIFTI:** Urtesí.

*Patáj Prifti e vendós Kryqin mi tryezen, dhe e temjanis reth e rotull dyke kenuar Perleshoren e Kryqit ne T. I:*

Ti shpetoje Zot, edhe ti bekoje pópullin, edhe trashegimin tent. Mundjen edhe triumfin, dhurona kunder barbáreve, edhe rúajna shtetin, me poteren e Kryqit tent.

*Passi e kendón Prifti nje here, Kori e perserít edhe dy here te tjera. Pastáj Prifti ben tri metanira, e merr Kryqin me dege besiloku, qendron perpara tryezes, edhe thote me ze te larte:*

**PRIFTI:** Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

**KORI:** Meshiró, o Zot (*nje qint here*).

*Ne keté mes Prifti shenón me Kryqin, pastáj unjet nga dale gjer mi dhé, dhe ngrihet gjithashtú. Pastáj kthehet me te djathte nga veriu, dhe thote me ze te larte:*

PRIFTI: Të lútemi edhe për Kryepeshkopin tonë (*aksh*), edhe për tërë vëllazërinë tonë me Krishtin.

KORI: Meshiró, o Zot (*nje qint here*).

*Pastáj Prifti, pasi unjet edhe ngrihet me Kryqin për heren e dytë, kthehet nga perëndimi, dhe thotë me zë të lartë:*

PRIFTI: Të lútemi edhe për Presidentin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për ushterinë dhe aniesinë amerikane, edhe për të gjithë të Krishterët besimorë dhe Ortodoksë.

KORI: Meshiró, o Zot (*nje qint here*).

*Pastáj Prifti, pasi unjet edhe ngrihet me Kryqin për heren e tretë, kthehet nga juga, dhe thotë me zë të lartë:*

PRIFTI: Të lútemi edhe për shpirtet e të Krishtereve besimorë, që prehen këtu dhe kudo.

KORI: Meshiró, o Zot (*nje qint here*).

*Pastáj Prifti, pasi unjet edhe ngrihet me Kryqin për heren e katërtë, kthehet nga lindja perëndi, edhe thotë me zë të lartë:*

PRIFTI: Të lútemi edhe për atá, që kanë shërbyer dhe po shërbejnë në këtë Kishë të Shenjtë, dhe për shendetin, për shpetimin, dhe për ndjesën e mëkátave të tyre.

KORI: Meshiró, o Zot (*nje qint here*).

*Pastáj Prifti, pasi ngrihet edhe unjet me Kryqin për heren e pestë, e vendós mbi tryezen, pastáj e ngre prapë me dege besiloku, dhe këndon Shkurtoren e Kryqit në T. IV:*

Ti që u-ngrite përmë Kryqin dykë dashur, shtetit të ri të themeluar prej teje, dhuroji kur-

dohere hir o Krisht Perendí, ep-i force dhe gezím, pópullit dhe shtetit tone, fal-i mundje dhe triúmf, ne çdo lufte mi armiqte; te paçim gjithenjë bashkeluftár, arme per paqe, tropé te pamundur.

*Pastáj Prifti e vendós Kryqin mi dhiskun, ben tri metanira, e pershendósh, edhe kendón ne T. II:*

Kryqit tent po i fálemi o Kryezót, dhe Ngjalljen tende te Shenjte lavderojme.

*Kori e perserít edhe dy here te tjera. Pastáj Prifti u ndan dege besiloku besníkeve, te cilet e pershendoshin Kryqin. Ne keté mes Kori kendón Troparet pasónjese ne T. II, pas IKOS TU EFRATHA:*

Kryqi po ngrihet sot, si druri jeteprures, ku Krishti u-mberthye, dhe nga mallkím' i vjeter, shpetój te gjithë njërezit.

Sot adhurójeni, me mall dhe besë Kryqin, dhe madheshtoni Krishtin, qe zbriti permi dhene, per hirin e besníkeve.

O Kryq i Zotit Krisht, mburonje dhe perkrahje, dhe mur i patronditur, dhe mprojtes i patundur, shpetím i gjithë njëresve.

LAVDI DHE TANI. Ejani me gezím, te gjithë te Krishteret, dhe Kryqin e çemuar, ku u-mberthye Krishti, me besë pershendósheni.

15. *Nikita, Deshmori i Shenjte.*

PERLESHORJA E SHEN NIKITES, T. IV,  
TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vajtje lot e mundím, kurorë te ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si

çperblím; se me fuqine tende, ka rezuar tiranet, dhe ka dermuar djajte, e kuxímt' e te dobet; aý per né po te lutet o Krisht Perendí, te shpethohen shpirtet tona.

16. *Shen Efimia, Deshmorja e Madhe.*

PERLESHORJA E SHEN EFIMISE, T. IV,  
KATEPLLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesú, me ze te math po te the-rrét: Dhenter ty te desherónj, dhe nat' e dite te kerkónj, dhe kryqesohem dhe varrosem tok me P'ageziimin; edhe vuanj tok me ty, qe te gëzohem tok me ty, edhe vdes per emrin tent, qe tok me ty te rronj ne qell; po si nje fli te shenjte prit-me mua qe per ty sakrifikohem. Dëgjona lutjet, e-dhe shpetoji, shpirtet tona prej vdekjes.

17. *Sofia, Deshmorja e Shenjte, dhe te bijat e saj, Besa, Shpresa dhe Dashuria.*

PERLESHORJA E SHEN SOFISE, T. I,  
TON TAFON SU SOTIR

Deshmore Shen Sofí, me tri bijat e tua, o Bes' e Dashurí, dhe ti Shprese shkelqyet, rrezuat me ment perdhé, urtesín' e Elíneve, u-munduat keq, dhe fagebardhe u-çfaqte, nuse me stolí, dhe me kuroren e Krishtit, fituat lavdí dhe nder.

18. *Eumeni, Ati yne Oshenár, peshkopi i Gortines, çudibéresi.*

19. *Trofimi, Sabati, dhe Dorimedonti, Deshmoret e Shenjte.*

20. *Shen Stathi, Deshmori i Math; Theopista e shoqja e tij; dhe te dy bijt' e tyre, Agapi dhe Theopisti.*

## PERLESHORJA E SHEN STATHIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, me vojtje lot e mundim, kurore te ndrçime prej teje múarne, si roge dhe si çperblim; se me fuqine tende, i rrezuan tirant; edhe i shtypne dajte, e kuximt' e te dobet; atá per né po te luten o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

*21. Kodrati, Apostulli i Shenjte prej Magnesise; Jonáj, Profeti i Shenjte.*

## PERLESHORJA E KODRATIT, T. III

Kodrát Apostull i Shenjte, lutju Zotit tone Jesú Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen e mekátave.

## PERLESHORJA E JONAJT, T. II

O Joná Profét i Shenjte, qe te kremtojme me bese, nermjetó perpara Zotit, te shpetohen shpirtet tona.

*22. Fokáj, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Sinopes.*

*23. Zénia e Shen Joanit, Profetit, Pareréndesit dhe Pagezorit te lavderuar.*

## PERLESHORJA E JOANIT PAGEZORIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Beronje qe s' kishe bir, defré gezohu taní, se zure ne gjirin tent, Profetin tone Joán, kandilin e díellit; ky ka per te ndrçuar, boten tone te verber; valle loj Zaharia, dyke thirrur me buje: Pro-

fét' i Krishtit afrohet, prítëni me gezím.

24. *Shen Thekla, Deshmorja e Madhe Isapostulle.*

PERLGSHORJA E SHEN THEKLES, T. T. IV,  
KATEPLLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesú, me ze te math po te the-  
rrét: Dhenter ty te desherónj, dhe nat' e dite te  
kërkónj, dhe kryqesohem dhe varrosem tok me  
Pagezimin; edhe vuanj tok me ty, qe te gezohem  
tok me ty, edhe vdes per emrin tent, qe tok me ty  
te rronj ne qell, po si nje fli te shenjte prit-me  
mua qe per ty sakrifikohem. Degjona lutjet edhe  
shpetoji, shpirtet tona prej vdekjes.

25. *Efrosina, Nena jone Oshenare.*

PERLGSHORJA E SHEN EFROSINES, T. T. IV,  
EN SI MITER AKRIVOS

Ti o Nene pikerisht, u-tregove shembell e Zo-  
tit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin  
Krisht, dhe vepra çfaqë per mesím, qe te çkuj-  
désemi per trup, se shkon me nxitím, dhe te kuj-  
désemi per shpirt, se eshte i pavdekur; pra shpir-  
ti yt po gezohet tok me Engjejte, o Efrosín' e  
Shenjte lavdí me ty.

26. *Shen Joani Theollogu.*

PERLGSHORJA E SHEN JOAN  
THEOLLOGUT, T. II.

O Apostúll i dashur i Krishtit, eja dhe shpetoje  
pópullin e deshperuar; lutjet e tua i pret ay, qe i

ke renc mi kraherorin; o Theollóg atí kerkoji, t' i perndanje ret' e barbáreve, dhe te na fale paqen, dhe perdelimin e math.

### THIRRJET, T. II, OTE EK TU KSILLU

Eni o besnikë sot ketú, qe ta lavderojme me kenge, Shen Apostullin Joán, kulmin e te úrteve, edhe te thélleve, Ungjillorin e káterte, qe ishte m' i dashur, se na thirri dhe na tha: Ne krye Fjala na qé. Pra si nje buçites u-çfaqe, se ne tere boten perhape, Krishterimin neper gjithë njérezit.

Dolle mik i dashur shigurisht, nxenes i besuar i zemres, i Shpetimtarit Jesú, mblodhe qe nga goj' e tij, si mblet' e lúleve, urtesin' e doktrinave, dhe na pasurove, boten edhe njérezit, si predikonjes me hir. Kisha pra qe mori dhuratat, ta çperbleu me buje te miren, me kremtim dhe kenge mirenjohese.

Lum' ti Theollóg o Shen Joán, se u-bere biri i Nenes, se Zotit tone Jesú, se qendrove nene Kryq, kur Krishti jepte shpirt, dhe te dha keté porrosí, me gojen e shenjte: "Nena jote eshte kjo, edhe ky eshte yt bir." Pra te lumerojme te gjithë, dhe te lavderojme me kenge, Apostull i Krishtit Ungjillór i Math.

LAVDI DHE TANI, T. II. O Ungjillór Joán, Dishépulli i dashur, shpetona nga reziket, nga helmet dhe lengatat, dhe grackat e demóneve.

### PASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Hirin e more o Shen Joán, nga gjuh' e zjarrete,

permi koke prej Shpirtit Shenjt, dhe gjuhe te zjarrte pate, dhe drite hape kudó, kur leçite Fjalën për te vyerit; me shkrim edhe me mesím, e për hape Ungjillin tent, me shkrepetime, i ndriçove te érretit, edhe jet' u dhé, pa mbarím jetedáshesve; bere sikunder te tregój, Mesónjesi Zoti Krisht, u prure vdekjen dhe humbjen, posi çperblím vdekjeprúresve. Falna paqen neve, dhe meshiren edhe driten, dhe jeten lart ne qell.

Múarme vesh nga shkrimet me ment, sikunder fole, se te drejten na thé o Shenjt, Joán Ungjillór i urte, edhe për né hollesisht, ndenje edhe shkrove sipas fákteve; qe dinje prej ngjárjeve, qe i pé me Dishépujte, me syt' e vete, perandáj pra i pari je, si nje lajmetár i Ungjillit te Zotit Krisht. Pra udhctove pa pushím, leçite si Ungjillór, edhe me zell te zjarrte, perhape fjalet e Zotit Krisht. Me zellin qe pate, edhe né qe te nderojme, na mbush dhe na ndriçó.

LAVDI DHE TANI, T. II. Ejani sot ketú, Joannin ta kremtojme, se predikój Ungjillin, perhapi Krishterimin, si Apostúll dhe Ungjillór.

### NDËNJËSORET, T. I, TON TAFON SU

I Shenjti Apostúll, qe na shkrove Ungjillin, dhe boten e ndriçón, me mesimet e tua, Joán i Madhi Apostúll, dhe i dashur i Zotit Krisht, te nderojme pra, me hymne dhe melodira, dhe te lútemi, qe te na falen mekatat, te gjithë besnikëve.

LAVDI DHE TANI. Si Nene te Jesújt, qe te gjithë te njohin, o Zonje Shen Marí, Virgjereshe pas lindjes, perikim pra me ty me mall, si e mire qe je per né, ty te kemi pra, né mekatáret si mprojtje, prej rezíkeve, dhe shpetimtare ne ngasjet, o Nene Hyjlíndese.

#### T. T. IV, TIN SOFIAN

Neverite anien tej ne liqén, edhe Krishtin pasove vullnetarisht, Joán Apostúll me nam, tere boten po e ndriçón, dhe prej nje peshkatarí u-bere nje Ungjillór, dhe i degjuar leçites i fjalës se Zotit Krisht. Sot pra jemi mbledhur, dhe me mall te nderojme, me buj' e me brohorí, dhe therresim me ze te math: Joán Theollóg i Math, lutu-i Krishtit te na fale ndjesen e mekatáve, neve qe po kremtojme, beserisht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Ti o porte qellore o Shen Marí, ti o mali i shenjte plot me shkelqím, o re udhëheqese, ti o shkalle e qëllshime, ti o Parájs' e méndeshme per Even shpetónjese, ti o thesár i botës i shtrenjte i çmúashim; ti o Nen e Shenjte, ti shpetimin na solle, nga fajet e prínderve. dhe mallkimet e gjýsherve. Perandáj te therresim: Nermjetó prane Birit tent, tu dhuronje ndjesen e mekatáve, te gjith' atyre qe lusin, lindjen tende te hýjeshme.

#### T. T. I, TON SINANARKHON

Apostullin Joán le ta lavderojme sot, Ungjillo-

rin e Fjalës edhe leçitësin, predikónjesin e kóm-beve dhe pópujve, se na mesój dhe na tregój, si ta njohim Zotin Krisht te vétëmin Bir te Zotit, dhe nermjetón pranë tij pa prerë, për shpëtimin e besnikëve.

LAVDI DHE TANI. Virgjëreshë dhe Nënë Marí Hyjlíndëse, që hidherimin e Evës e ktheve në gëzim, të hymnojmë në besnikët dhe të fátëmi, se na çlirove plotërisht, nga mallkimi prinderór, o Zonj' e permibekuar, pra lutu për në pa prerë, që të shpëtojmë prej rezikëve.

#### SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë, po ti perkrah-më dhe shpëtojmë, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionën, do të turpërohëni prej Zotit, dhe do të fishkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqësi, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë krijesën për jetëlindje.

PARËVARGU. Fama e tij u-perháp në tërë botën.

#### UNGJILLI I MËNGJËZIT PAS JOANIT

M' atë kohë, Jesúj, pasi u-ngjall në vdëkuresh, u-çfaq në Dishëpujtë, dhe e pyeti Simón Pjetrin: "Simón i Jonájt, a më dó më tepër se ketá?" Pjet-

ri iu-përgjëq: “Po, o Zot, ti e di se të dua.” Dhe Jesúj i tha: “Kullót-i shqerrat e mia.” Pastáj e pyeti për se dyti: “Simón i Jonájt, a më dó?” Pjetri iu-përgjëq: “Po, o Zot, ti e di se të dua.” Dhe Jesúj i tha: “Rúaj-i dhent’ e mia.” Pastáj e pyeti për se treti: “Simón i Jonájt, a më dó?” Dhe Pjetri u-helmua që e pyeti për se treti, dhe iu-përgjëq: “O Zot, ti i di të gjitha, ti e di se të dua.” Dhe Jesúj i tha: “Kullót-i dhent’ e mia. Me të vertete po të them, kur ishe më i ri, e ngjeshnje brezin, edhe shkonje ku të deshnje, po kur të mplakesh, do t’ i ndesh dúarte, dhe një tjetër do të ngjeshje, dhe do të veç atjë ku nukë dó.” Dhe këtë e tha për të treguar më ç’ fare vdekje do ta lavderonte Përendinë. Dhe pastáj i tha: “Eja pas meje.” Dhe Pjetri u-kthye, dhe vuri re që po vinte pas edhe Dishépulli, që deshte Jesúj, i cili i ra në krahe-rorin, natën e darkës, dhe e pyeti: “Zot, cili është atë që të tradhetón?” Edhe Pjetri, kur e pá, e pyeti Jesunë: “O Zot, po ky ç’ dó?” Edhe Jesúj iu-përgjëq: “Kur unë dua që ky të qëndronje gjer sa të kthehem prapë, ti ç’ ke? Ti eja pas meje.” Pra, doli fjala në vëllëzerit, që atë Dishépull nukë vdes. Dhe Jesúj nuk i tha që nukë do të vdiste, po vetëm: “Kur unë dua që ky të qëndronje gjer sa të kthehem prapë, ti ç’ ke?” Ky është Dishépulli, që i ka parë me sy dhe i ka shkruar këtë, edhe në e dimë se dëshmimi i tij është i vertete. Ka edhe shumë të tjera, që bëri Jesúj, të cilat po të shkruhen nga një e nga një, kujtónj se as bota e tërë

nuke do t' i nxere librat, qe do te shkruhen. Amín.

*Psalmi 51 pa ze.*

LAVDI. Me nermjetimet e Apostullit, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

*Meshirome, o Perendi meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.*

T. II. O Ungjillór Joán, Dishépulli i dashur, shpetona nga reziket, nga helmet dhe lengatat, dhe grackat e demóneve.

### SHKURTORJA, T. II.

Lavdit' e tua s' nmeroohen, o Shen Joán me nam, pus i cudírave, dhe burím i sherímeve, nermjetár i palodhur i njéresve, o Theollóg edhe mik i Jesújt.

### SHTËPIA

Madheshtít' e tua munt te tregohen, aqe sa munt te maten lartcsite e qellit edhe thellcsite e detit, a sa munt te nmeroohen yjte dhe rerrat e zálleve; se Zoti te kurorczój me shume dafina, o Theollóg edhe mik i Jesújt.

### SINAKSARI

Me njezét e gjashte te ketí múaji kujtojme fjetjen e Shen Joanit, Apostullit te lavderuar, Ungjillorit edhe Theollogut, edhe Dishépullit te dashur te Jesú Krishtit.

Me nermjetimet e tij, o Perendí, meshiro-na. Amín.

### ZBRITCSORET, T. IV, ANIKSO.

*Kendohet qe me 22 te Shtatorit gjer me 20 te Nentorit dhe qe te Díelen e Gjíthe Shenjtóreve gjer me 27 te Korrikut.*

I. Ja gojcn e çel taní, i frymesuar prej Shpiritit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithc çudít' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pamosur jetcsór, ti shiguroji gjith' atá, qe te kendojnc plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorezoi me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perendór, qe po misherohet i larti Zot prej Virgjereshes, Abakumi si Profét, e pá dhe tha me ze te math: Zot i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lavdí: Ti o Virgjeresh' e pamartuar, Zotin e jetes qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besníkeve.

VI. Keté te kremte e lusim sot, per Zonjen e dhe Nenen Hyjlíndese, gjithc hyjméndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin qe lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po Krijetarit lart, dhe kerccnimin me zjarr, e shkelne me trimcrí, psallnin me brohorí: Zot

lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e denuar per te djegur, prej zjarrit i ka shpetuar lindj' e Zotit Krisht, si simból ne vjeterí, dhe si veperím taní, dhe tere boten po e mbleth per keng' e lavderím: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartesoni permi te gjitha jetet.

IX. Gjithc njérczit, kecení me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Engjejt' e qellit eni kremtójeni, keté te shenjtc panaír te Kryezonjes Marí, dhe therrisni: Ti je mé e lúmura, Virgjércsh' e kulluar Hyjlíndese.

#### DERGIMCSORET, T. II, TIS MATHITES

Si biri i gjemónjesit, ner njérczit buçite, o Apostúll o Shen Joán: "Ne krye ishte Fjala." Se dyke qene Dishepull, i Jesújt mé i dashur, i mblo dhe qe nga goj' e tij, gjithc dogmat me besc edhe me mall, si nje mblét' e lúleve te Parajsces, dhe botes me Ungjillin tent, ia perhape me vala.

Nga Kryqi Shpetimtari Krisht, kur te pá Virgjercshc, tok me Dishépullin besník, ta tregój dhe te thirri: Ky eshte biri yt taní; ashtú edhe dishépullit: Nena jote kjo eshte per gjithcnjé, perandáj po e kremtojme me besc, até edhe Hyjlíndesen, Nenen dhe Ungjillorin.

#### LAVDERIMET, T. T. IV, O TU PARADOKSU

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Aý qe ish pesh-

katár, na u-çfaq Apostúll i Math, Ungjillór i Kísheve, shpetimtari i njéresve, me predikime, kombet i kthen në fe, me tonjë Kryqi, boten per-pjét' e ngre. Oh ç' fare gjah të math, na i solli Zotit Krisht ky Shenjt me nam! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe me mall.

Ç' është kjo çudí dhe kjo habí! Na e dergój Zot' i Math, Shen Joanin prej qiellit, dele midis újqerve, po aý nuk u-tremp aspák, bishat i beri, shqerra me bes' e fe, boten e tere, me predikim e ndroj. Sa vepra pa tregim, na ke ber' o Ungjillór i Zotit Krisht. Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

Ç' është kjo çudí dhe kjo habí! Si pus per né po burón, uj' e vala me urtesí, per të gjithë njérezit, Ungjillori i Zotit Krisht. Prej tij doktrinát, rjedhin posi luménj, hir dhe sherime, kunder lengátave. Sa vepra me lavdí, dhe çudí ke bere ti o Shen Joán! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

LAVDI, T. T. IV. O Ungjillór Shen Joán, virgjerór dhe engjellór, Theollóg i Perendise, i leçite botes kryqcsimin, gjakun dhe ujen që rothne nga brinja e Krishtit, prej të cilit fituam jeten e pasosur per shpirtet tona.

TANI. Prit-i Hyjlíndese, lutjet e sherbetóreve, perkraha dhe shpctona, prej rezíkeve dhe hélmeve.

## SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA

O mburónj' e patronditur e të Krishtëreve, nermjetare e palodhur e besnikëve, ver-u veshin mekatáreve me dhempsherí, se po të thërresim bescrisht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjeshe: Ndiha me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe mpro përhere gjith' atá, që të lusin o Hyjlíndese.

*Kjo Shkurtore kendohet në Meshen që me 22 të Shtatorit gjer me 8 të Nentorit.*

## APOSTULLI

Fama e tij u-perháp në tërë botën. Qelli tregón lavdinë e Perendisë.

Prej Letres I së Përgjithme të Joanit.

Asnjé nuk e ka parë nonjé herë Perendinë; po në dajim njerjatrín, Perendia banón në zemrat tona, dhe dashuria e tij është e mbaruar në né. Nga kjo e dimë, që banojmë në Perendinë, dhe Perendia banón në né, se na ka dhënë Shpirtin e Shenjtë. Edhe né e kemi parë, dhe po dëshmojmë që Ati na e ka dërguar të Birin, Shpetimtarin e botës. Pra, cilidó që refén se Jesúj është i Biri i Perendisë, Perendia banón në até, edhe ay në Perendinë. Dhe né e kemi njohur, dhe e kemi besuar dashurinë, që ka Perendia për né. Perendia është dashurí; dhe ay, që ka dashurí, banón në Perendinë, dhe Perendia në até. Keshtú dashuria jonë bëhet e mbaruar, dhe keshtú do të dalim faqebardhë në ditën e gjyqit, se ashtú, sikunder

esht aý, jemi edhe né ne këtë botë. Ne dashurine nuk ka frike, se dashuria e mbaruar e dbon friken, se frika ka denimin, dhe aý, qe ka frike, nuk e ka dashurine të mbaruar. Edhe né e duam, se aý na ka dashur i pari.

### UNGJILLI PAS JOANIT

M' atë kohe, po qendronin pranë Kryqit të Jesújt e-jema dhe e motra e s'emes, Maria e Kleopes, edhe Maria Magdalena. Jesúj, pra, kur e pá t' emen dhe dishépullin e dashur atjé pranë, i tha s' emes: "Moj grua, ja yt bir." Pastáj i tha dishépullit: "Ja jot' emë." Dhe qe atë orë dishépulli e mori në shtëpinë e vetë. Ky është dishépulli, qe i ka parë me sy dhe i ka shkruar këtë, edhe né e dime se deshmimi i tij është i vertetë. Ka edhe shumë të tjera, qe bëri Jesúj, të cilat po të shkruhen nga një e nga një, kujtonj se as bota e tërë nuk do t' i nxerë librat, qe do të shkruhen. Amín.

### KUNGATORJA

Fama e tij u-perháp në tërë botën.

27. *Kalistrati, Deshmori i Shenjte, dhe të dyzët e nente shkoket e tij Deshmore.*

28. *Haritoja, Ati ynë Oshenár dhe konfesór; Baruku, Profeti i Shenjte.*

### PERLESHORJA E SHEN HARITOS, T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Me lotë derdhur si rëké, shkretëtirën e that' e vadite për lërim, dhe me vajtím dhe psherëtím,

gjer një qint herë peme mblodhe për çdo mundim; u-çfaqë pra si yll, dhe e ndriçove botën me çudí, Harito At i Shenjtë dhe Oshenár, lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

29. *Kirjaku, Ati ynë Oshenár dhe anakorét.*

### PERLGSHORJA E SHEN KIRJAKUT, T. I, TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Qytetar i shkretëtirës edhe Engjell nga trupi, edhe çudibërës u-çfaqë, Kirják o At i Shenjtë; me lutje vengjill' e agjerim, fitove dhuratë të qëllshme, se semundjet dhe lengatat na i sheron, dhe ndjen mekatat e shpirtit; lavdë atë që të falë fuqí; lavdë atë që të dha kurorë; lavdë atë që veperon, me anën tendë shërime.

30. *Grigori, Hierodëshmori i Shenjtë, peshkopi i Armenisë së Madhe.*

### PERLGSHORJA E GRIGORIT TË ARMENISË, T. IV, QË TROPON METOKHOS

Shok i menyrave, nëkembës i frónëve, u-çfaqë kor' e Dishëpujve, zbatove me veperim kudó, çdo teorí edhe predikim; perandáj të verteten e leçite prer' e drejt, dhe për besën leftove gjer në gjak, si një Dëshmor o Shen Grigor; lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

### TË KREMTET E TETORIT

1. *Anania, Apostulli i Shenjtë, një prej të Shtatëdhjeteve; Romani Mellodi, Oshenari.*

2. *Kipriani, Hierodëshmori i Shenjtë; Justina Virgjresha, Dëshmorja e Shenjtë.*